KËRKESË
Nr.978/3, datë 26.7.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore-Shkodër" (objektet).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen, dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik".

Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP" do të kompensohen për efekt shpronësimi pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave që do të miratojë kërkesën për shpronësim, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi "Proces regjistrimi nga ZRPP", këto pasuri do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të ketë përfunduar ky proces dhe të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë DPRR-së.

Për të gjitha pasuritë për të cilat është bërë shënimi "I pakonfirmuar" do të kërkohet konfirmimi pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Shkodër ose nga drejtoria rajonale e ALUIZN-it Shkodër nëse këto prona janë të konfirmuara ose janë të përfshira në proces legalizimi.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi